



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 108 prot.

Kamëz, më 19.07.2022

V E N D I M

Nr. 92 Datë 19/07 2022

MBI

“MIRATIMIN E VLERËS TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET QË PREKEN NGA PROJEKTI UNAZA E MADHE E TIRANËS, SHESHI SHQIPONJA BULEVARDI I RI, SHKOZË, NJËSIA ADMINISTRATIVE PASKUQAN”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 19.07.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.80 Datë 19.07.2022 në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, Ligjit Nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; Ligj nr. 22/2018 “Për strehimin Social” VKM nr. 409 datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve pa leje që nuk legalizohen”; vendimit nr.132, datë 22.12.2021 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e detajimit të buxhetit të Bashkisë Kamëz për vitin 2022-2024”; Urdhër nr.571 datë 15.07.2022 “Për ndjekjen dhe trajtimin e poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi I projektit “Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja” Bulevardi i Ri, Shkozë Njësia Administrative Paskuqan”, Këshilli Bashkiak Kamëz”,

V E N D O S I:

1. Miratimin e vlerës e subvencionimit të qirasë për familjet që preken nga projekti Unaza e Madhe e Tiranës, sheshi Shqiponja Bulevardi i Ri, Shkozë Njësia Administrative Paskuqan sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Kamëz, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Nr.Frymësh	Sasia	Çmimi mesatar (lekë pa tvsh)
1	Banesa me qira (Apartament tip garsonierë)	muaj	1-2	1	15,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

2	Banesa me qira (Apartament 1 + 1)	muaj	3-4	1	21,000
3	Banesa me qira (Apartament 2 + 1)	muaj	5	1	25,000
4	Banesa me qira (Apartament 3 + 1)	muaj	6-8	1	27,000

2. Vlera e subvencionimit të qirasë është e barasvlefshme me qiratë mesatare në treg sipas vlerave të paraqitura në këtë vendim.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI

